



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

Syllabus i lëndës Ndërmarrësia

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Ndërmarrësia
Niveli:	BSc.
Status i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II (semestri IV)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Lënda e Ndërmarrësisë është një qasje e integruar e botëkuptimit mbi ndërmarrësinë dhe ndërmarrësit që do të ligjërohet duke ju ofruar studentëve njohuritë më të reja në lëminë e Ndërmarrësisë, duke ju ofruar njohuri mbi problemet aktuale që takohen dhe debatohen në jetën akademike dhe praktike në këtë lëmi, njohuri kjo e domosdoshme për studentët tanë që të jenë në rrjedha të trendeve bashkëkohëore të bizneseve ndërkombëtare. Kjo lëndë do ofroj të dhëna të mjaftueshme rreth koncepteve biznesore, analizës mjedisore, bazës legjislative për operim biznesor, marketingut dhe të dhënave tjera financiare të cilat janë të nevojshme për ndërmarrësinë.
Qëllimet e lëndës:	Lënda synon që studentëve t'u ofron njohuritë themelore mbi çështjet teorike – shkencore në fushën e ndërmarrësisë. Thënë shkurt, qëllimet themelore të cilat pretendohen të arrihen janë: të shpjeguarit se çka duhet bërë, dhe si duhet qasur qëllimit madhor të të mësuarit të studentëve, dhe të tjerëve, për ndërmarrësinë; të kuptuarit më të lehtë, të ndodhive dhe trendeve në biznesin e vogël privat në ekonomi dhe ekonominë kosovare në veqanti si dhe rolit që luajnë ndërmarrësit në ndërtimin e një ekonomie të qëndrueshme; procesi i ndërmarrësisë, nga studentët dhe të tjerët, nga entuziastët e inovatorët, të përdoret si metodë e pasurimit të tyre, përmes zënjes së dijes, aftësive, dhe shkathtësive për të pasur sukses, jo vetëm si ndërmarrës, por edhe si qytetarë produktivë; ekzistojnë indikacione të forta se edukimi

	ndërmarrës do të prodhojë ndërmarrës më të mirë, dhe më të shumtë në numër, që do ndihmojnë zhvillimin e gjithëmbarshtëm.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Në fund të lëndës studentët duhet të jenë të aftë: • Për të identifikuar se çfarë është Ndermarresia e cfare eshte ndermarresi • Per te diskutuar dhe shpjeguar ceshtjet specifike qe lidhen me biznesin, konkurencen, tregjet dhe mjedisin biznesor • Për të përshkruar dhe ilustruar startegjite ndermarrese. • Per te njohur dhe aplikuar modelet e organizimit biznesor • Për të kuptuar elementet kryesore per iniciimin e biznesit • Për të kuptuar politikat publike rreth ndermarresise • Për të qene i gatshem per te krijuar nje plan biznesi final		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata, Kolokvium	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	2	2
Detyra shtëpie	1	5	5
Seminare, projekte, prezentimet,etj.	1	3	3
Koha e studimit vetanë të studentit	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Përgaditja përfundimtare për provim	5	4	20
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:	• Metoda e punës do të përmbajë ligjërime teorike edhe ato praktike duke përfshirë këtu punën individuale e në veçanti atë grupore. • Studentët do të përballen me gjetjen e rezultateve më të mira për përballje me raste të ndryshme duke e luajtur rolin e ndermarresit, do të përballen me raste konkrete të cilat do t'i ndihmojnë atyre që të jenë të gatshëm për ndermarre biznesore ne fusha apo drejtime te caktuara. • Metodologjia perfshin prezantimin e i temës mësimore,rast studimi apo detyrë lidhur me temën e ligjëruar dhe		

	diskutim mbi te. Përsëritja e temës paraprake nga grupi i caktuar i studentëve, analiza dhe diskutime
Metodat e vlerësimit:	- Vijimi i ligjeratave dhe Plani i Biznesit 10% - Testi I 20 % - Testi II 20% - Provimi përfundimtar 50%
Literatura	
Literatura bazë:	1. Bazat e Sipërmarrjes, Marsela Robo, Andrea Xhavara, Tiranë 2012.
Literatura shtesë:	2. The Startup Owner's Manual: The Step-By-Step Guide for Building a Great Company. Steve Blank, Bob Dorf, 2012 3. Peter F. Drucker: Inovacioni dhe Ndërmarrësia, Shtëpia Botuese e Librit Universitar 2010, Tiranë. 4. Djuro Horvat, Zeljko Tintor: Ndërmarrësia, Trgovacka Akademija, Zagren 2005, perkthim ne shqip, Prishtine 2008
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	- Hyrje ne Ndermarresi - Njohje me lenden - Prezentimi I syllabusit - Koncepte Kyç
Java e dytë:	- Njohuri te pergjithshme mbi ndermarrjen
Java e tretë:	- Cka eshte ndermarresia dhe si lidhet me veprimtarine njererzore?
Java e katërt:	- Ndermarresia dhe biznesi
Java e pestë:	- Organizimi i biznesit
Java e gjashtë:	- Organizimi i biznesit-vazhdim
Java e shtatë:	- Tregu dhe sjellja e konsumatoreve
Java e tetë:	TESTI INTERMEDIAR
Java e nëntë:	- Institucionet financiare dhe roli i tyre ne ndermarresi
Java e dhjetë:	- Planet e biznesit
Java e njëmbëdhjetë:	- Përgaditja dhe menaxhimi i ndërmarrjes-Marketingu
Java e dymbëdhjetë:	- Baza ligjore dhe ndermarresia
Java e trembëdhjetë:	- Llogaritja e kostove per fillimin e nje ndermarrje
Java e katëmbëdhjetë:	- Roli i teknologjise informative ne ndermarresi
Java e pesëmbëdhjetë:	TESTI I DYTE

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
- Është e domosdoshme përgatitja dhe dorëzimi i planit të biznesit për të hyrë në provim - Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektoj institucionin dhe rregullat shkollore

- Duhet të respektoj orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit/ID në teste dhe provim
- Gjatë hartimit të planit të biznesit, studenti duhet t'i respektoj rregullat e parashtruara nga mesimdhënësi i lëndës